



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPK/DPK1</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>03-02/137/17</u>
Nr. l faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>20.01.2017</u>
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4682/16, për z. Esad Abdullahu – Drejtor Bordi në Kompaninë Rajonale të Ujësjetllësit “Hidrodrini”, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4682/16, për z. Esad Abdullahu – Drejtor Bordi në Kompaninë Rajonale të Ujësjetllësit “Hidrodrini”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Abdullahu, është hetuar për konflikt interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat “GRANIT - E”.

Ai fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, z. Isa është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Abdullahu, është bindur për kufizimin e funksionit menaxherial në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për t'i bërë ndryshimet e nevojshme.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë me të cilën vërtetohet se ai ka emëruar një “person të besueshëm”, në funksionin e personit të autorizuar, ashtu siç parashihet me Ligjin PKI. Me këtë ai ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

